



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/07
Datë: 18.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 2.4, nenit 10 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, dhe në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK - së, me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2021 merr këtë:

V E N D I M

Për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19

A. [Zbatimi territorial]

1. Ky vendim zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve të huaj nga Republika e Kosovës]

2. Qytetari i huaj që hyn në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ata me leje qëndrim të përkohshëm ose përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me risk të lartë sipas listës zyrtare të ECDC-së, duhet të kenë test RT-PCR negativ për COVID-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit.

3. Përfshirë nga pika 2. bëjnë:

3.1. Nëse qytetari i huaj hyn në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohet nga Kosova brenda 3 ore përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda 3 ore;

3.2. Qytetari i huaj që punon si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga Covid-19;

3.3. Qytetari i huaj që kalon nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojë territorin e Kosovës brenda 5 orësh;

3.4. Diplomatatë e huaj të akredituar në Kosovë si dhe familjarët e tyre.

3.5. Personi që ka dëshmi për marrjen e vaksinës kundër COVID-19.

C. [Mbrotjtja dhe siguria në punë]

4. Në institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera, të paraqiten në punë vetëm stafi esencial. Staf esencial konsiderohen punëtorët prezenca fizike e të cilëve në vendin e punës është e domosdoshme për kryerjen e detyrave të punës.
5. Obligohen përgjegjësit përkatës në institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera, që në bashkëpunim me punëtorët të definojnë stafin esencial.
6. Punëdhënësit publikë dhe privatë udhëzohen të krijojnë kushtet për kryerjen e detyrave të punës nga shtëpia për punëtorët që nuk janë staf esencial për nevojat e punëdhënësit.
7. Të gjitha punëtorët shtatzëna duhet të lirohen nga obligimi për t'u paraqitur në punë duke iu krijuar mundësinë që të punojnë nga shtëpia.

Ç. [Masat e përgjithshme të mbrojtjes dhe higjienës]

8. Obligohen institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera të mbajnë dezinfektues për duar dhe maska për fytyrë në vende të qasshme në hyrje të objektit dhe në ambientet e brendshme.
9. Obligohen institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera që në hyrje të çdo objekti të vendosin shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga Covid-19 (përfshirë shenjën e ndalimit të hyrjes në objekt pa maska, respektimin e distancës).
10. Obligohen përgjegjësit e institucioneve publike e private dhe në subjektet e tjera që të kryejnë dezinfektimin dhe ajrosjet e hapësirave të mbyllura.
11. Bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është obligative, në të gjitha rastet përveç:
 - 11.1. Gjatë ngasjes së automjetit vetëm apo me anëtarët e ngushtë të familjes;
 - 11.2. Gjatë vrapit dhe çiklimit;
 - 11.3. Gjatë ecjeve jashtë zonave të banuara dhe jo në grupe me më shumë se 4 persona të të njëjtës familje.

D. [Kufizimi i qarkullimit]

12. Kufizohet qarkullimi i qytetarëve nga ora 22:30 deri në 05:00, përveç:
 - 12.1. Rasteve të natyrës urgjente (për të kërkuar ndihmë mjekësore, blerje të barnave, për të ofruar kujdes ose ndihmë mjekësore, për të shmangur dëmtimin ose për t'i shpëtuar një rreziku lëndimi);
 - 12.2. Qarkullimit për personelin shëndetësor, të sigurisë, dhe operatorët që kryejnë punë dhe shërbime publike;
 - 12.3. Operatorëve ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zinxhirit të furnizimit (përfshirë transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të veçantë nga sistemi EDI i Administratës Tatimore të Kosovës.
13. Obligohen punëdhënësit të sigurojnë që punëtorët e tyre që i nënshtrohen kufizimit nga pika 12 kanë kohë të mjaftueshme për të udhëtuar nga dhe në banesat e tyre.

Dh. [Institucionet e arsimit]

14. Institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit vazhdojnë mësimin sipas udhëzuesit përkatës për sektorin e arsimit.
15. Konviktet lejohet të punojnë sipas rregullit një student në një dhomë.
16. Të gjitha institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskurzionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor apo të nxënësve – studentëve.

E. [Paraqitja për skemat sociale dhe pensionale]

17. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve udhëzohet të lirojë të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që menaxhohen nga MFPT-ja nga paraqitja e rregullt në zyrat përkatëse për qëllime të evidentimit siç kërkohet me ligjet përkatëse.

Ë. [Kufizimi i mbledhjeve publike dhe private]

18. Ndalohen të gjitha grumbullimet me rrezikshmëri të lartë të shpërndarjes së infeksionit, me më shumë se 30 persona (mbledhjet, seminarët, trajnimet). Pavarësisht numrit të personave, mbajtja e pritjes për ngushëllim/kryeshëndoshë dhe organizimi i dasmave ndalohet.
19. Përjashtim nga pika 18, bëjnë mbledhjet e Kuvendit të Kosovës, mbledhjet e Qeverisë, apo mbledhjet me interes të veçantë publik, të cilat lejohen pavarësisht numrit të personave.
20. Lejohen funeralet vetëm me pjesëmarrje të familjes së ngushtë, jo më shumë se 30 persona.

F. [Qendrat tregtare dhe operatorët e tjerë ekonomikë]

21. Lejohet veprimtaria e qendrave tregtare sipas udhëzuesit përkatës.
22. Obligohen të gjithë operatorët të cilët për veprimtari ekonomike kanë tregtinë me shumicë dhe pakicë që të përcaktojnë numrin maksimal të klientëve në lokal në të njëjtën kohë sipas rregullit - 1 person për 8 m². Këta operatorë obligohen të shënojnë në hyrje numrin maksimal të klientëve të lejuar në të njëjtën kohë. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku lejohen të qëndrojnë klientët.

G. [Puna me palë]

23. Personi përgjegjës i institucionit publik apo privat dhe i operatoreve ekonomik, obligohet që të ndalojë rreshtimin apo tubimin brenda dhe jashtë ambientit të punës/biznesit, përveç nëse ata mbajnë distancë fizike prej të paktën dy metra nga grupet e tjera të personave.

Gj. [Gastronomia]

24. Shërbimet e gastronomisë lejohen të zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me udhëzuesin përkatës. Lejohen deri në 40 klient për 100m² (4 persona për 10 m²). Sipërfaqja llogaritet për zonën ku shërbehet ushqimi dhe pijet.
25. Ambienti duhet të konfigurohet në mënyrë që klientët e ulur në tavolina të ndryshme të ndahen duke u përmbushur distanca prej të paktën 1 metri në mes karrigeve/ulseve.

26. Klientët duhet të qëndrojnë ulur në çdo kohë në çdo ambient të operatorit ekonomik në të cilin lejohet shërbimi i ushqimit apo pijeve përveç:
 - 26.1. Gjatë hyrjes apo daljes nga ambienti i operatorit ekonomik;
 - 26.2. Ndërsa paguan porosinë;
 - 26.3. Gjatë shkuarjes ose kthimit nga tualeti;
 - 26.4. Kur është e nevojshme për qëllime të shëndetit dhe sigurisë.
27. Nëse një zonë në ambient të jashtëm ku shërbehet ushqimi dhe pijet, është e mbuluar nga një çati, tendë, ose element tjetër statik, të paktën dy anët e plota të të gjithë zonës duhet të jenë të hapura për jashtë dhe nuk duhet të bllokohen në mënyrë të konsiderueshme nga asnjë mur ose pengesa të tjera fizike të padepërtueshme.
28. Nëse zona në ambient të jashtëm ku shërbehet ushqimi dhe pijet është e pajisur me një çati të lëvizshme dhe çatia tërhiqet, çatia dhe të paktën njëra anë e plotë e zonës së ngrënies në natyrë duhet të qëndrojnë e hapur.
29. Shërbimi "dërgesë me porosi" lejohet të funksionojë edhe pas orës 22:30, pas pajisjes me leje të veçantë nga sistemi EDI (ATK).
30. Në hotele, pas orës 22:30, shërbimi i pijeve dhe ushqimeve lejohet edhe në zonën e përcaktuar për ngrënie dhe pije, vetëm për musafirët e këtyre subjekteve, të cilët verifikohen përmes listës që tregon personat që qëndrojnë për fjetje dhe që ofrohet nga subjekti përkatës.

H. [Tregjet dhe therja e kafshëve]

31. Lejohet veprimtaria e tregjeve publike të automjeteve, kafshëve dhe shpezëve deri në 40 për qind të kapacitetit.
32. Therja e kafshëve lejohet vetëm në ambientet e autorizuara për këtë qëllim.

I. [Transporti publik]

33. Transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri 50 për qind të kapacitetit dhe sipas udhëzuesit përkatës.
34. Taksitë lejohen të punojnë me 1 udhëtar prapa ose 3 udhëtarë prapa nëse janë anëtarë të së njëjtës familje.

J. [Teatrot, bibliotekat, etj.]

35. Institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe komunave (siç janë teatrot, bibliotekat, filarmonitë, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme) lejohet të punojnë duke shfrytëzuar 30 për qind të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime).

K. [Sporti dhe rekreacioni]

36. Lejohen aktivitetet sportive pa prezencë të publikut, të cilat duhet të realizohen në përputhje me protokollet vendore dhe ndërkombëtare sportive.
37. Lejohet shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme për aktivitete individuale rekreative sipas udhëzuesit përkatës.

38. Shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme bëhet në proporcion 1 klient në 8m².
39. Aty ku është e mundur në software të fitnesit/palestrës të përcaktohet numri maksimal i klientëve që mund të kenë qasje në hapësirat e fitnesit.
40. Obligohet që personi përgjegjës i fitnesit/palestrës të ketë kujdes të veçantë në pikun e vizitës së klientëve, e që llogaritet koha nga ora 17:00 – 20:00, që të respektohet distanca e përcaktuar në udhëzues.
41. Obligohet vendosja e shenjave informuese dhe dezinfektuesve (apo mjeteve të tjera për pastrimit) në secilën pajisje të fitnesit me qëllimit të vetëdijësimit dhe dezinfektimit të tyre nga secili klient pas përdorimit.

L. [Udhëzuesit dhe sqarimet]

42. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që të nxjerrë udhëzuesit e përkohshëm, të përgjithshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, si në vijim:
 - 42.1 Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e Covid-19;
 - 42.2 Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
 - 42.3 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të të gjitha niveleve;
 - 42.4 Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
 - 42.5 Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore;
 - 42.6 Udhëzues i Përkohshëm për fitnese, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
 - 42.7 Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik;
 - 42.8 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
 - 42.9 Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
 - 42.10 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj.
43. Udhëzuesit nga pika 42 janë të detyrueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohen.
44. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që në rast nevojë të nxjerr sqarime për pikat e këtij vendimi.

Ll. [Zbatimi]

45. Obligohet Ministri i Shëndetësisë, AUVK dhe Policia e Kosovës, që në bashkëpunim me shtabet emergjente komunave, të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi dhe të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raport javor (çdo të premte deri në orën 16:00).
46. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK dhe IKShPK të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportin javor (çdo të premte deri në orën 16:00) për zbatimin e masave, gjendjen në institucionet shëndetësore, gjendjen epidemiologjike si dhe parashikimet për dy javët në vijim.
47. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, në territorin e Republikës së Kosovës të nxjerrë vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShP-së.

48. Obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e masave, vendimeve të tjera dhe udhëzuesve përkatës në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
49. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.
50. I vetmi autoritet që mund të interpretojë këtë vendim është Ministria e Shëndetësisë, ndërkaq çdo institucion tjetër mund të ofrojë sqarime për kategoritë respektive për të cilat aplikohet ky vendim, vetëm pas miratimit të atij sqarimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

M. [Shfuqizimi i vendimit 01/05]

51. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/05 i datës 05.04.2021.

N. [Hyrja në fuqi]

52. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe vlen deri në një vendim tjetër.

A r s y e t i m

Referuar raportit të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nga 13 marsi 2020 deri më 16 prill 2021, numri rasteve të konfirmuara me COVID-19 është:

- pozitive: 101.153
- vdekje: 2.061

Në një situatë të tillë të cenimit të shëndetit publik, janë të domosdoshme masa për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 sipas rekomandimeve të IKShPK-së dhe të ekspertëve. Duke e përcjellë me kujdes situatën epidemiologjike, me vëmendje të veçantë numrin e infektiveve të reja, rastet e vdekjes, kapacitetet infrastrukturore dhe të burimeve njerëzore në shëndetësi, Qeveria cakton masat që njëkohësisht synojnë parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së infeksionit dhe minimizimin e dëmit ndaj ekonomisë.

Ministria e Shëndetësisë ka bashkërenduar vendimmarrjen me palët e interesit, të cilat kanë qenë të ndikuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga pandemia. Qeveria vëren se këto palë kanë ushtruar të drejtën e tyre për ndikim demokratik në vendimmarrje, në përputhje me nenin 45.3 të Kushtetutës.


Marrja e masave është bërë duke u kushtuar rëndësi tri objektivave:

- Parandalimi i përhapjes së sëmundjes dhe moscenimi i kapaciteteve spitalore;
- Për aq sa është e mundur, moscenimi i aktiviteteve ekonomike, por duke pasur prioritet ruajtjen e jetës dhe shëndetit të popullatës;
- Ruajtja e shëndetit mendor dhe fizik të qytetarëve.

Masat e përcaktuara në këtë vendim si dhe afatet kohore shërbejnë që situata epidemiologjike të mbahet nën kontroll. Ndryshimi i situatës epidemiologjike nuk përjashton vendime dhe masa të reja konform situatës së re.

Rrjedhimisht, në bazë të rekomandimeve të dhëna nga IKShPK, ministritë e linjës, palët e interesit dhe ekspertët përkatës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Simjali



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/07

Datë: 18.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19, 27 dhe 33 të Rregullores nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të adresimit të prioritetit nacional për sigurimin e vaksinave kundër COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë për plotësim - ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr.01/2015 Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale duke evituar procedurat që përcaktohen me Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.
2. Plotësimi - ndryshimi i këtij akti nënligjor përfshin përcaktimin e kushteve/kritereve specifike për të siguruar vaksinat kundër COVID-19.
3. Gjatë hartimit të plotësim ndryshimit të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr.01/2015 Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale, Ministria e Shëndetësisë duhet ta ketë parasysh standardet për hartimin e akteve normative të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.
4. Autorizohet Ministri i shëndetësisë të anuloj Udhëzimin Adminsitrativ Nr.01/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


A r s y e t i m

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale (i pa publikuar në gazetën zyrtare) në aspektin e adresimit të çështjeve të cilat kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave ligjore për procedim me produkte biologjike (vaksina) në mënyrën siç është nënshkruar nuk lejon që asnjëri lloj i vaksinave të aprovuara në nivel botëror deri tani që të regjistrohen dhe përdoren në Kosovë (përveç rasteve të donacioneve apo ato pa Autorizim për Marketing). Kjo për shkak se në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ kërkohet që për një produkt të tillë fillimisht të ketë regjistrim me procedurë të

centralizuar apo decentralizuar në Agjencitë Evropiane të Barnave (EMA) dhe Agjencinë Federale të Barnave të ShBA-së FDA si parakusht për regjistrim në Agjencinë e Kosovës për Produkte Medicinale. Mirëpo duke qenë se deri tani asnjë vaksinë për COVID-19 nuk ka regjistrim të plotë në EMA apo FDA (pra kanë regjistrim të kushtëzuar apo emergjent) kjo e pamundëson Autorizimin për Marketing në Republikën e Kosovës.

Udhëzimin Administrativ Nr.01/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale në përmbajtjen aktuale të saj, përveç problemeve të tjera teknike në gabimet në referimet juridike të cilat bëjnë që të jetë i pazbatueshëm juridikisht, njëkohësisht nuk adreson saktë çështjet të cilat kanë të bëjnë me emergjencën aktuale lidhur me pandeminë COVID-19 dhe pamundësojnë regjistrimin në cilën do procedurë për marrjen e autorizimit për marketing (qoftë të plotë, në mënyrë unilaterale apo të kushtëzuar) si edhe proceset tjera që kanë të bëjnë me lejen e importit, banderolat, çështjet e etiketimit si edhe ato të farmakovigjilencës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/07
Datë: 18.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/07
Datë: 18.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Konfirmohet vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës për procedim të mëtutjeshëm për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës të vendimeve si në vijim:
 - 1.1. Vendimi Nr. 01/61, i datës 03.02.2021, për aprovimin e Raportit Preliminar Financiar për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2020; dhe
 - 1.2. Vendimi Nr. 05/61, i datës 03.02.2021, për aprovimin e ndryshimeve në tabelat 3.1, 3.2, 4.1 dhe 4.2 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2 të nenit 9 të këtij ligji.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë vendim t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/07
Datë: 18.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë Nr. 01/69 të datës 15.03.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 1. e vendimit të Qeverisë Nr. 01/69, datë 15.03.2021, ashtu që emërtimi "për gardianet" zëvendësohet me emërtimin "për Personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës".
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë